

<b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT</b>	<b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS</b>	<b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU</b>
--	---	---

17 maj 2012

**SCC-10-0200**

*Paditësit*

1. H.S.
2. A.S.
3. R.S.
4. S.S.
5. Sh.S.
6. A.S.
7. N.S.

**Të përfaqësuar nga avokati J.R.**

**Kundër**

*I Padituri*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga Ilir Konushevci nr. 8, Prishtinë

Kolegji i Specializuar i përbërë nga Alfred Graf von Keyserlingk, Kryesues i Kolegjit, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, Gjyqtarë, lëshon këtë

### A K T G J Y K I M

1. **Padia refuzohet si e pabazuar.**
2. **Paditësit obligohen që bashkërisht të paguajnë tarifat gjyqësore në shumë prej 15 euro.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Më 9 gusht 2010, Paditësit ushtruan padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar kompensim në para nga i Padituri për vdekjen e A.S., punëtor i NSH-së X në X. Indjeri A.S. ishte bashkëshorti i Paditëses 1 dhe i ati i Paditësve 2 deri 7. Ai ishte vrarë më 6 janar 2004 në vendin e tij të punës kur u përpoq që të mbronte shefin e prodhimit nga një sulm prej një kolegu pune të pushuar nga puna. Paditësit mendojnë se sipas nenit 122 të Ligjit të Kosovës për Marrëdhëniet e Punës (Gazeta e Kosovës 14.4.1989) i Padituri është përgjegjës për dëmin dhe kërkojnë me parashtrësën e tyre, të datës 9 gusht 2010, 1000 euro kompensim. Ata kërkojnë edhe një vlerësim nga ana e ekspertit për dëmet tjera materiale dhe jo-materiale të cilat duhet të kompensohen.

I Padituri mendon se padia duhet të refuzohet si e papranueshme ose ndryshe si e pabazuar. Ai argumenton se në bazë të nenit 18.2 të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit ajo nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi, veprimi ose mosveprimi që i atribuohet një Ndërmarrjeje.

Paditësit argumentojnë se i Padituri ka bërë privatizimin e NSH-së ku ka punuar A.S. dhe se ajo i ka marrë asetet dhe detyrime e Ndërmarrjes. Prandaj, sipas Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, Komisioni për Likuidimi i caktuar nga i Padituri duhet të jetë përgjegjës për kompensimin e dëmeve.

Dhoma e Posaçme e ka mbajtur seancën dëgjimore më 19 prill 2012.

Arsyetimi ligjor

Padia nuk është e bazuar.

Mund të mbetet çështje e hapur nëse në kohën kur A.S. u vra në vendi e tij të punës ishte në fuqi ligji i cili e bënte punëdhënësin – subjektin ligjor që posedonte X në X përgjegjës për vdekjen e tij. Edhe po të kishte qenë kështu, edhe pse punëtori nuk po vepronte me faj i Padituri nuk do të ishte përgjegjës. Neni 18.2 i Ligjit të Kosovës Nr.03/L-067 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit përcakton

Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi, veprimi ose mosveprimi që i atribuohet një ndërmarrje dhe asnjë ndërmarrje nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi, veprimi ose mosveprimi që i atribuohet Agjencisë. Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë veprimi ose mosveprimi të drejtorëve, menaxherëve ose personave të tjerë kontrollues të ndërmarrjeve pavarësisht se a janë emëruar apo jo ata drejtorë, menaxherë a persona të tjerë kontrollues të ndërmarrjes nga Agjencia.

As Rregullorja e UNMIK-ut Nr 2005/48 nuk e bën përgjegjës të paditurin.

Prandaj padia duhej të hedhet poshtë si e pabazuar.

Shpenzimet

Në bazë të nenit 12 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme dhe në pajtim me Rregullat Plotësuese Proceduralë në lidhje me Taksat Gjyqësore, të Dhomës së Posaçme, që janë në fuqi nga data 13 dhjetor 2010, tarifata e Dhomës në bazë të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/02 (ADJ) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë si vijon:

Për paditë me vlerë deri në 1.000 euro (neni 10.1): € 15

Për lëshimin e Aktgjykimit (neni 10.12): është e njëjta si më lartë.

Shpenzimet e procedurës barten nga pala e pasuksesshme, në këtë rast nga Paditësit.

Paditësit tanimë kanë paguar shumën prej 15 €, kështu që Paditësit do të paguajnë në Dhomën e Posaçme shumën tjetër prej 15 €.

I Padituri nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për kompensim të shpenzimeve të veta të procedurës dhe pasi që i Padituri përfaqësohet nga avokati i vet, i Padituri nuk gëzon të drejtën që të marrë kompensim për tarifat e arsyeshme të avokatit.

Këshillë ligjore

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet Ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t'i dërgohet edhe palës tjetër dhe të dorëzohet tek Trupi Gjykses **nga Ankuesi** brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Ankesave dëshminë se e ka dërguar Ankesën edhe tek pala tjetër.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur Ankuesit i është dërguar aktvendimi me shkrim.

**Kolegji i Ankesave e refuzon ankesën si të papranueshme nëse Ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.**

I Padituri mund të ushtrojë përgjigje tek Kolegji i Ankesave brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek ankuesi dhe tek pala tjetër.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Ankesave dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek Ankuesi dhe tek Kolegji i Ankesave.

Alfred Graf von Keyserlingk,  
Kryesues i Kolegjit